VENDIM
Nr.899, datë 10.11.2010

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.632, DATË 18.9.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT TË PUNËKËRKUESVE TË PAPUNË, FEMRA", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 8 të ligjit nr.7995, datë 20.9.1995 "Për nxitjen e punësimit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 4 të vendimit nr.632, datë 18.9.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas fjalës " ... sociale ..." shtohen fjalët "... emigrante të kthyera, me probleme ekonomike ...".

2. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha